

Raport lidhur me aksesin në banesat sociale, shërbimet publike dhe kushtet e jetesës të Komunitetit Rom dhe Egjyptian

1. Hyrje

Qeveria shqiptare ka miratuar, në vitin 2009, Planin e Veprimit për Dekadën e Përfshirjes së Romëve. Strehimi dhe infrastruktura është një nga gjashtë prioritetet e këtij plani. Ndërsa për komunitetin egjyptian qeveria nuk ka ndonjë strategji të veçantë, por ky komunitet trajtohet mbi bazën e strategjisë kombëtare të përfshirjes sociale si dhe strategjive sektoriale të arsimit, shëndetësisë, punësimit, etj.

Gjatë muajve Tetor - Nëntor 2011, KSHH realizoi një cikël monitorimesh, të cilat kishin për qëllim vrojtimin e kushteve të banimit, situatën e infrastrukturës, aksesin në shërbimet komunale, aksesin në programet e strehimit social si dhe aksesin e popullsisë Rome dhe Egjyptiane në programin e ndihmës ekonomike.

Monitorimi u fokusua në: (i) në të gjitha shërbimet komunale, që janë përgjegjësi e qeverisjes vendore, d.m.th., furnizimi me ujë të pijshëm, infrastruktura në lagjet e banuara nga Romët, heqja e mbeturinave të ngurta, shërbimi i pastrimit; (ii) kushtet e banimit dhe situata e strehimit për popullsinë Rome; (iii) aksesin në programet e strehimit social; (iv) aksesin në programin e ndihmës ekonomike.

Nga monitorimet dhe mbledhja e informacionit u konstatua që çështja e strehimit për komunitetin egjyptian nuk vlerësohet si problematike, kjo dhe për shkak të mosidentifikimit të vetë personave si pjesëtarë të këtij komuniteti. Kjo ka bërë që pushteti vendor mos të parashikojë politika strehimi të veçanta për këtë kategori dhe për këtë arsye edhe në këtë raport, në të shumtën e rasteve, ne i referohemi minoritetit rom.

Mbledhja e të dhënave (puna në terren), u realizua përmes intervistave të drejtëpërdrejta, fokus grupeve dhe vizitave në lagjet e banuara nga Romët. Në total u realizuan 13 intervista të thelluara¹, 13 fokus grupe dhe 13 vizita në terren. Monitorimi u realizua në 13 njësi të qeverisjes vendore dhe kryesisht në ato njësi që kanë përqëndrim më të madh të popullsisë Rome dhe Egjyptiane, konkretisht, Tiranë (njësitë bashkiake Nr. 5, 11, 4, 1), Komuna Levan, Fier, Bashkitë Elbasan, Shkodër, Durrës, Fushë-Krujë, Korçë, Kukës dhe Berat.

2. Programet sociale të strehimit

"Programe sociale strehimi" janë programe, të cilat shërbejnë për strehimin e familjeve dhe të individëve, që nuk janë në gjendje ekonomike e sociale të përballojnë ofertën e tregut të lirë të

¹ Persona të intervistuar: Jeta Seití, kryetare njësia Bashkiake 5, Tiranë, Hasan Vathi nënkryetari i Njësisë Bashkiake 11, Laprakë, Tiranë, nënkryetari i Njësisë Bashkiake 4, Tiranë, Mirela Shuli Nënkryetare e Njësisë Bashkiake Nr.1, Tiranë, Xheladin Malaj, Kryetari i Komunës, Levan, Dritan Cepa, nënkryetar Bashkia Elbasan, Roina Luli, Sektori i Strehimit, Bashkia Shkodër, Mene Xhaferri, drejtoreshë e Departamentit të Ndihmës Sociale, Bashkia Durres, Gjon Balli, Kryetar i Bashkisë Fushë-Krujë, Dylbere Sefaj, punonjëse e sektorit të ndihmës sociale, Vaskë Thimo, përgjegjës i sektorit të strehimit në Bashkinë Korçë, Fasli Tota, Drejtor i Shërbimeve Publike në Bashkinë Kukës; znj Evgjëni Pelivani, nënkryetare e Bashkisë Berat.

banesave ose atë të kredive hipotekore². Programet sociale të strehimit klasifikohen në tre kategori:
a) Programe të banesave sociale me qira; b) Programe të banesave me kosto të ulët; c) Programe të pajisjes së truallit me infrastrukturë.

Programi i banesave sociale me qira është ndër programet më të gjera dhe që krijon më shumë hapësira për komunitetet në nevojë dhe grupet e rrezikuara. Në këtë program përfshihen:

- a) banesat, që ndërtohen apo blihen nga tregu i lirë prej bashkive ose organizatat jofitimprurëse, të cilat jepen me kontratë qiraje sociale;
- b) banesat ekzistuese, në pronësi të personave fizikë ose juridikë, të cilat janë klasifikuar nga organet e qeverisjes vendore, apo nga organizatat jofitimprurëse si banesa sociale, që mund të jepen me qira për familjet që përfitojnë bonus strehimi;
- c) objektet e dala jashtë funksionit, si rezultat i mbylljes së një veprimtarie, të cilat kanë kaluar në pronësi të bashkive dhe janë miratuar për t'u kaluar në fond banesash sociale me qira, në përputhje me planin rregullues urbanistik³.

Familjet që mund të përfitojnë nga programet sociale të strehimit dhe kriteret e përzgjedhjes së tyre përcaktohen në ligjin përkatës të sipërpërmëndur.

3. Gjetjet e evidentuara lidhur me kushtet e jetëses

3.1 Kushtet e banimit

Minoriteti Rom banon kryesisht në disa zona, si në Tiranë (pranë lumit Lana në njësinë Nr.5, Rr “Frona Bardhi”, pas pallatit me shigjeta; në zonën e Hekurudhës, Laprakë, Bregu i lumit, tek ish fusha e druve Allias; ish Uzina Autotraktorëve); Komuna Levan në Fier; Lagjia 5 Maji Rrapisht në Elbasan; lagjia Nishtullë – Shkozet në Durrës; Lagjia Rome, Rr.Kastrioti në Fushë Krujë; minoriteti Rom i vendosur në Rr. “Viktimat e Radovecit” Lagja 8, Tulla e vjetër në Korçë; në lagjien 30 Vjetori në Berat. Ndërsa komuniteti Egjyptian është më i integruar me popullsinë e shumicës dhe kjo e bën më të vështirë identifikimin e zonave ku janë vendosur ata, por pavarësisht nga kjo në disa zona është më e evidente prania e tyre, si në Korçë në Lagja 8, Tulla e vjetër dhe në Shkodër në Lagjen Iliria.

Kushtet e banimit për komunitetin Rom dhe Egjyptian, në përgjithësi, janë të vështira dhe rreth 30% e tyre jetojnë në banesa të papërshtatshme. Situata nuk paraqitet e njëjtë në të gjitha njësitë vendore të monitoruara. Ndërkohë diferenca të mëdha ekzistojnë në kushtet e banimit ndërmjet komunitetit Rom dhe atij Egjyptian.

Kushtet e banimit janë më të vështira për popullsinë Rome që banon në qytetin e Tiranës, Shkodrës, Korçës, për një pjesë të këtij komuniteti që banon në bashkinë e Durrësit dhe komunën e Levanit. Në pjesën më të madhe banesat në këto zona janë barake dhe banorët e tyre nuk kanë përfituar dhe nuk mund të përfitojnë nga procesi i legalizimit dhe nuk mund të sigurojnë një strehim të përshtatshëm. Ndërkohë banesat që ndodhen pranë bregut të lumit, gjatë periudhës së dimrit, rrezikojnë të përmyten dhe ka patur edhe raste konkrete kur kasollet janë marrë nga lumi duke rrezikuar edhe jetën e banorëve.

² Ligji nr. 9232, neni 2 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane

³ Ligji Nr. 9232, neni 3

Përgjithësisht banesat nuk i kanë të gjitha ambientet e nevojshme. Shpesh herë i njëjti ambient shërben për shumë funksione. Ai përdoret nga këto familje si dhomë ndenje, fjetjeje dhe gatimi. Numri i banorëve që banojnë në të njëjtin ambient varion nga 4 deri në 10 persona. Në përgjithësi mbizotërojnë familjet e mëdha dhe sipërfaqja për frymë është shumë e vogël në të gjitha NJV të monitoruara. Banesat shpesh herë nuk janë të pajisura me tualete.

Planet e zhvillimit dhe investimet e reja që priten të fillojnë në qytetin e Tiranës prekin një pjesë të banesave Rome. Të tilla janë investimet që po bëhen për unazën e madhe të Tiranës⁴ dhe investimet që mendohen të kryhen për tramvajin. Aktualisht nuk është bërë publik asnjë projekt mbi zhvendosjen dhe strehimin e këtyre familjeve.

Në bashkinë e Durrësit ndeshen dy situata krejt të ndryshme. Një pjesë e komunitetit Rom jeton në banesa të mira, që janë në proces legalizimi, ndërkohë që pjesa tjetër jeton në banesa të papërshtatshme, të ndërtaura me mjete rrethanore dhe me një mungesë të theksuar të infrastrukturës së nevojshme në mjedisin që i rrethon (*rrugë, kanalizime, furnizim me ujë të pijshëm*). Infrastruktura lë shumë për të dëshiruar edhe në bashkinë e Beratit. Zona e banuar nga romët ka rrugë të pashtruara dhe është e mbuluar nga mbeturinat urbane.

Ndërtimi i unazës së madhe të qytetit të Tiranës prek banesat e komunitetit Rom në rrugën “Frano Bardhi” (*tek shkolla teknologjike*) dhe ata tek bregu i lumit (ish-fusha e druve, Allias). Qytetarët deri tani ata nuk kanë asnjë informacion se ku duhet të zhvendosen. Për të realizuar zhvendosjen e tyre duhet të merren në kohë të gjitha masat dhe të informohet komuniteti. Gjithashtu komuniteti Rom në Njësisë Bashkiake Nr .11 preken nga projekti për ndërtimin e tramvajit dhe për këtë projekt komuniteti nuk është i informuar se çdo të ndodhë me këto familje nëse fillon zbatimi i projektit.

Gjithashtu tek parku i liqenit artificial në Tiranë (pranë shkollës ‘Marin Barleti’-njësia bashkiake 5), është vendosur rishtazi një komunitet Rom. Në këtë mjedis mungon infrastruktura e nevojshme dhe prezenca e tyre ka shkaktuar ndotje të mjedisit nga mbeturinat.

3.2 Furnizimi me ujë të pijshëm/kanalizimet

Furnizimi me ujë të pijshëm përgjithësisht ofrohet nga ndërmarrja e UKT në të gjitha zonat e banuara nga familjet Rome në qytetin e Tiranës dhe Beratit. Megjithatë u konstatuan raste, si në Njësinë Bashkiake Nr. 1, 4 dhe 5⁵, në Tiranë, ku disa familje Rome nuk kishin akses në furnizimin me ujë të pijshëm, megjithëse infrastruktura përkatëse ekzistonte në këto zona. Këta banorë e sigurojnë ujin duke u furnizuar me kova nga tubacionet kryesore.

Mungesa e ujit të pijshëm u konstatua dhe në komunën e Levanit. Ndonëse rrjeti i ujësjellësit është i lidhur me këtë qendër të banuar, ai nuk funksionon dhe një pjesë e madhe e familjeve e siguronin ujin nga zona të tjera, ose nga pusët, që në të njëjtën kohë i përdornin edhe për vaditjen e tokës së punuar. Në këtë vendbanim probleme u konstatuan dhe me kanalizimevet e ujërave të zeza.

Furnizimi me ujë të pijshëm dhe mungesa e kanalizimeve të ujrave të zeza ishin probleme që u konstatuan dhe në bashkitë Elbasan, Shkodër, Durrës dhe Fushë-Krujë. Në bashkinë e Elbasanit

⁴ Këto investime kalojnë tek zona e pallatit me shigjeta dhe në Allias

⁵ Banesat pranë lumit të Lanës dhe tek rruga “Frano Bardhi”

megjithëse janë kryer punime ato aktualisht janë jashtë funksionit, ndërkohë që në bashkinë e Shkodrës mungesa e këtyre shërbimeve justifikohet nga pushteti vendor me informalitetin e zonës në të cilën banon komuniteti Rom.

3.3 Kushtet higjenike

Kushtet higjenike janë shumë të këqija në të gjitha zonat e banuara nga Romët në qytetin e Tiranës, bashkinë Korçë dhe bashkinë Shkodër. Mungesa e higjenës në ambientet rrethuese u konstatua në të gjitha zonat informale. Shumica e barakave nuk kishin tualet, dhe për këtë, përdorshin tualete të përbashkëta ose mjedise “të hapura”.

Banesat e komunitetit Rom në bashkinë e Korçës ndodhen pranë pikës së grumbullimit të mbetjeve urbane. Jetesa, sidomos gjatë stinës së verës, bëhet shumë e vështirë për shkak të djegies së plehrave, tymit të shumtë, por edhe prej erës së keqe nga dekompozimi i plehrave.

3.4 Strehimi social

Një pjesë e vogël e komunitetit Rom dhe Egjiptianë në bashkinë e Tiranës kanë përfituar dhe/ose janë të përfshirë në programet e strehimit social. Familjet rome të cilat kanë qenë të vendosura pranë bregut të Lumit të Lanës janë përfshirë në listën e familjeve të cilat do të përfitojnë shtëpi sociale (*në kompleksin e banesave sociale Shkozë*). Këto familje kanë qenë të strehuara në baraka, por pas prishjes së banesave, ato u përfshinë në bonusin e qerasë. Këto familje janë asistuar për përgatitjen e dokumentacionit përkatës për të përfituar nga programi i banesave sociale me qera. Megjithatë kohët e fundit në media është përfolur se komuniteti i Romëve që kanë qëndruar në zonën e Babrrusë në Tiranë do të transferohen në një repart ushtarak afër Kombinatit⁶.

Për familjet Rome ka pengesa dhe vështirësi specifike që nuk mundësojnë përfshirjen e tyre në programet e strehimit social, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Këtu mund të përmendim mungesën e lejeve të banimit dhe rregjistrimin e tyre në zyrat e gjendjes civile. Ka shumë familje Rome që megjithëse ka vite që banojnë në qytetin e Tiranës nuk kanë transferuar dokumentacionin e nevojshëm për tu konsideruar si banorë të qytetit të Tiranës.

10 familje nga komuniteti Rom kanë përfituar nga programi i strehimit social në bashkinë e Elbasanit. Numri i familjeve që aplikojnë për këto programe nuk është i madh pasi familjet Rome nuk janë të rregjistruara si të pastreha dhe në mjaft raste ato nuk kanë mundësi financiare për të paguar këstet/qeratë e banesave sociale. Një situatë e ngjashme vihet re dhe në qytetin e Durrësit, të Fushë-Krujës dhe atë të Kukësit. Në bashkinë e Beratit ka përfituar nga banesat sociale me qera 1 nga 48 familje rome, ndërsa bashkia e Shkodrës nuk është e përfshirë në këtë program. Në disa bashki banesat sociale në pjesën më të madhe janë planifikuar për familje të vogla dhe janë të papërshtatshme për familjet rome me numër të madh pjesëtarësh⁷.

Numri i aplikimeve për banesa sociale ka qenë në total 2300 në bashkinë e Korçës, prej të cilave 65 janë nga familje rome dhe 550 nga familje egjiptiane. Këshilli Bashkiak do të shpërndajë 96 shtëpi

⁶ Shih Gazeta Shqip, date 6 janar 2012, faqe 25

⁷ Nga intervista me nënkryetaren e bashkisë Berat

për familjet që kanë aplikuar, por pa pasur kriteret favorizuese për këto komunitete. Kjo bashki ka dhënë 3 shtëpi për komunitetin rom, por jo në të gjitha rastet këto familje kanë përballuar pagesën e kredisë⁸.

3.5 Punësimi dhe gjendja ekonomike

Sipas bisedave me pjesëtarë të komunitetit Rom, mënyra e vetme e sigurimit të mbijetesës është vetpunësimi dhe kryesisht duke mbledhur hekura dhe kanaçe në kazanët e plehrave dhe në pikën e grumbullimit të plehrave. Gjithashtu një pjesë e tyre merret me shitjen e rrobave dhe mallrave të përdorura. Përfshirja në këto veprimtari ekonomike bën që të ardhurat ekonomike të jenë të ulta dhe të ndryshojnë në varësi të sezonit, në bazë të punës që ato bëjnë dhe shpesh herë dhe nga kushtet e motit. Situata është e njëjtë në bashkinë e Tiranës, Korçës, Elbasanit, Shkodrës.

Pothuajse të gjithë Romët e vetpunësuar nuk paguajnë sigurime shoqërore dhe shëndetësore dhe për rrjedhojë nuk mund të përfitojnë as pension pleqërie dhe as shërbime shëndetësore falas pasi bëjnë punë “në të zezë”.

Niveli i papunësisë në radhët e këtij komuniteti është i lartë. Njësitë bashkiake në qytetin e Tiranës në disa raste kanë marrë iniciativën për ta përfshirë këtë komunitet në programet e punëve publike, një strategji e ndërmarrë për të edukuar sensin e punës dhe pavarësisë së këtij komuniteti. Megjithatë këto iniciativa jo gjithmonë kanë qenë të sukseshme.

Përveç përfshirjes në aktivitetet e vetpunësimit të përmendura më sipër, komuniteti Rom në komunën e Levanit merret dhe me bujqësi dhe përfiton të ardhura nga tregtimi i produkteve bujqësore. Ndërkohë që në bashkinë e Durrësit një pjesë e këtij komuniteti punon në sektorin e komunaes dhe pjesërisht tek punët verore gjatë sezonit turistik.

3.6 Migrimi/Emigrimi

Një pjesë e mirë e familjeve Rome që banojnë në qytetin e Tiranës kanë migruar nga qytete si Fushë-Kruja, Fieri, Lushnja dhe Rrogozhina. Arsyeja e migrimit ka qënë ekonomia e dobët në qytetet ku kanë banuar më parë dhe mundësitë më të mëdha që krijon metropoli për tu përfshirë në aktivitetet vetëpunësimi, që janë burimi kryesor i të ardhurave të tyre.

Migrimi ka ndikuar në përkeqësimin e kushteve të banimit, pamundësinë për tu përfshirë në skemat e ndihmës ekonomike, për rastet kur nuk kryhet transferimi i regjistrimit në gjendjen civile, etj.

Një pjesë e vogël e komunitetit Rom në komunën Levan dhe bashkinë Berat ka emigruar në Greqi për të punuar dhe siguruar të ardhura dhe për të mbajtur familjet.

3.7 Ndihma ekonomike

⁸ Nga intervista me z. Vaskë Thimo, përgjegjës i sektorit të strehimit në Bashkinë Korçë

Një numër shumë i vogël familjesh rome përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike. Në shumë raste këto familje janë asistuar dhe mbështetur nga organizatat rome, të cilat i kanë ndihmuar me përgatitjen e dokumentacionit dhe ndjekjen e procedurave.

Në njësinë Bashkiake nr. 5 përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike 112 familje rome ose 26% e familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike. Gjithashtu 26 familje të tjera marrin pagesë paaftësie. Ndërkohë që në Njësinë Bashkiake nr.11 asnjë nga 36 familjet Rome nuk përfitonte nga skema e ndihmës ekonomike. Këto familje ishin nxjerrë nga kjo skemë dhe ishin përfshirë në programet e nxitjes së punësimit⁹.

16 familje Rome dhe 44 familje Egjyptiane përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike në bashkinë Fushë-Krujë. Kjo përbën ¼ e përfituesve të skemës për këtë bashki. Një pjesë e familjeve nuk mund të përfitojnë nga kjo skemë pasi ata kanë përfutuar nga ligji mbi privatizimin e tokës bujqësore. Ndërkohë që në bashkinë e Korçës 95% e përfituesve nga 1400 familje, që përfitojnë ndihmë ekonomike, i përkasin komuniteteve Rome dhe Egjyptiane.

3.8 Programe mbështetëse

Në territorin e bashkisë së Tiranës ka shumë OJF që ofrojnë shërbime për komunitetin Rom. Në Njësinë Bashkiake nr.5 ka një qendër, që mbështet fëmijët e këtij komuniteti, të cilët kalojnë një pjesë të ditës në ambientet e kësaj shoqate, ku përveç programeve mësimore, kryejnë edhe aktivitete të tjera. Gjithashtu TLAS, apo shoqata të tjera që mbrojnë të drejtat e fëmijëve ndihmojnë herë pas here komunitetin rom apo egjyptian me ndihmë ligjore falas dhe asistencë për të regjistruar fëmijët e paregjistruar në gjendjen civile. Qendra Eden ofron mbështetje për komunitet egjyptian në Njësinë Bashkiake nr.1.

Bashkia Elbasan ofron shërbime për komunitetin Rom nëpërmjet qendrës komunitare që operon prej disa vitesh në lagjen e Romëve dhe që menaxhohet plotësisht nga bashkia Elbasan. Si rezultat i bashkëpunimit me QFP (Qendrën Rajonale të Formimit Profesional) vajzave dhe grave Rome u ofrohen kurse të ndryshme falas, si parukeri, rrobaqepsi, etj, ndërsa burrave kurse për mekanik, axhustator, tornitor, etj. Kontribut të veçantë në këtë bashki kanë dhënë dhe shoqatat Ndihmë për Fëmijët, Terre Des Hommes, Tjetër Vision, Një Endërr me Shumë, të cilat kanë zbatuar shumë projekte në ndihmë të këtij komuniteti.

Programe dhe projekte të ndryshme në ndihmë të këtij komuniteti ka dhe në bashkënë e Korçës si: projekti për fëmijët që braktisin shkollën, që zbatohet në bashkëpunim me Terre Des Hommes ; kampet verore për fëmijët (në të cilat ofrohet një vakt ushqimore falas); shkolla ku zhvillohen mësim dhe ju jepet vakt falas; etj.

3.9 Shërbimi shëndetësor

Në përgjithësi të dy komunitet kanë akses në infrastrukturën shëndetësore, por mungesa e sigurimeve shëndetësore vështirëson marrjen e disa shërbimeve shëndetësore që nuk mund të ofrohen pa pagesë. Në disa raste pjesëtarët e komunitetit Rom pretendonin se ka diskriminim ose se ata duhet të paguajnë nën dorë që të përfillen për të marrë këto shërbime.

⁹ Program i cili nuk ka rezultuar i suksesshëm dhe afatgjatë për këtë komunitet.

4.Rekomandime

- Sugjerojmë që të inicohen më shumë projekte për përmirësimin e kushteve të banimit në të gjitha vendbanimet e popullsisë Rome dhe Egjyptiane
- KSHH sugjeron bashkëpunimin më të mirë të Ujësjetës, njërive vendore dhe komuniteteve Rom e Egjyptiane, me qëllim përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm të rrjedhshëm në të gjitha zonat ku është konstatuar mungesa e tij, si dhe për përmirësimin e rrjetit të ujësjetës kanalizimeve dhe infrastrukturës përkatëse.
- Të shihet mundësia e inicimit të programeve të reja të strehimit social, të cilat të krijojnë mundësi për një akses më të madh të këtij komuniteti në këto programe. Për këtë së pari duhet paraprirë me një studim i hollësishëm për kushtet specifike të pronësisë, të regjistrimit dhe mënyrës së jetesës së të gjitha grupet komuniteteve.
- Të ofrohen më shumë mundësi të formimit profesional për përfaqësuesit të dy komuniteteve, të cilat do të rrisnin shanset e tyre për punësim dhe përmirësimin e kushteve të jetesës dhe zyrat e punësimit t'i ndihmojnë këto komunitete me përparësi për punësim.
- Të rritet mbështetja dhe asistenca nga njësitë e pushtetit vendor për të gjitha familjet që aplikojnë për skemën e ndihmës ekonomike.
- Rekomandojmë njësitë e qeverisjes vendore që të informojnë komunitetin në mënyrë të vazhdueshme mbi të gjitha programet e mbështetjes sociale dhe procedurat për të përfituar nga këto programe.
- Të sigurohet bashkëpunim dhe koordinim më i mirë mes organeve të pushtetit vendor dhe INSTAT si dhe përdorimin e të dhënave të Censurit të popullsisë me qëllim që të evidentohet numri i Romëve dhe Egjyptianëve që jetojnë në zonat ku ata janë të përqëndruar. Kjo do të ndihmonte në hartimin dhe zbatimin më të mirë të politikave sociale në të ardhmen.
- Sugjerojmë që njësitë e pushtetit vendor të rrisin bashkëpunimi me shoqërinë civile për të ofruar sa më shumë shërbime në ndihmë të këtij komuniteti si dhe për të bashkërenduar iniciativat në këtë drejtim, në mënyrë të veçantë për shkollimin e fëmijëve të këtij komuniteti, kualifikimin profesional, regjistrimin e fëmijëve të lindur, transferimin e regjistrimit të gjendjes civile, celebrimin e martesave etj.
- Ministria e Punës Cështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në bashkëpunim me pushtetin vendor dhe shoqërinë civile të bashkërendojnë veprimtaritë me qëllim një shpërndarje më të drejtë dhe sa më të barabartë të mbështetjes për komunitetin Rom dhe Egjyptian në të gjithë territorin e vendit.

- Sugjerojmë që Këshillat Bashkiake përkatës të mbajnë parasysh, më mirë se deri tani, problematikën e strehimit të këtyre komuniteteve gjatë miratimit të zërave të buxhetit të njësisë përkatëse të pushtetit vendor.